NJOFTIM PËR PËRPUNIM TË TË DHËNAVE PERSONALE TË PUNONJËSVE DHE PERSONAVE PËRFAQËSUES NË BZhMV ShA ShKUP

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale rregullon mbrojtjen e të dhënave personale si të drejta dhe liri themelore të qytetarëve, dhe veçanërisht të drejtën e privatësisë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale, transferimin e të dhënave personale në vende të tjera dhe ofrimi i të dhënave personale për përdoruesit.

Ky njoftim ka të bëjë me përpunimin e të dhënave Tuaja personale nga Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut ShA Shkup, si dhe për të drejtat Tuaja.

Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut ShA Shkup i kushton vëmendje të madhe mbrojtjes së të dhënave personale në të gjitha proceset e saj afariste, duke i zbatuar standardet e përcaktuara me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe aktet interne të përcaktuara në bankë.

INFORMATA BAZË

Kontrollues: Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut ShA Shkup (BZhMV)

Selia: Dimitrie Çupovski nr. 26, 1000 Shkup

Numri tatimor: 4030998350604

Numri i regjistrimit: 5240425

Telefoni: 02/3115-844

Faqja e internetit: www.mbdp.com.mk

Posta elektronike: info@mbdp.com.mk

Të dhënat për punonjësit dhe personat përfaqësues në BZhMV përpunohen me qëllim të realizimit dhe përmbushjes së disa të drejtave dhe detyrimeve, të cilat rrjedhin nga rregulloret ligjore si për personat ashtu edhe për BZhMV.

MBLEDHJA E TË DHËNAVE PERSONALE NGA ANA E KONTROLLUESIT

Ne mbledhim të dhënat tuaja personale nga ju kur:

- aplikoni për punësim në bankë,
- lidhni një marrëdhënie pune në bankë duke lidhur një marrëveshje për punësim,
- të përmbushë rregulloret ligjore

QËLLIMI I PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Ne përpunojmë të dhënat tuaja personale në mënyrë që të përmbushim të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga legjislacioni i mëposhtëm:

- Ligji për marrëdhëniet e punës;
- Ligji për evidencën në lëmin e punës;
- Ligji për tatimin mbi të ardhurat personale;
- Ligji për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore;
- Ligji për sigurimet shëndetësore;
- Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor;
- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve;
- Ligji për përmbarim;
- Ligji për festat e Republikës së Maqedonisë;

- Marrëveshje kolektive në nivel të BZhMV dhe të tjera.

KATEGORITË E TË DHËNAVE PERSONALE TË CILAT NE I PËRPUNOJMË

- Emri dhe mbiemri
- Adresa dhe vendbanimi
- NUIQ
- Numri i letërnjoftimit
- si dhe një grup të dhënash shtesë për kategoritë e ndryshme të subjekteve të të dhënave personale, në varësi të rregullores për llojin përkatës të kategorive të subjekteve (shembull: të dhëna për anëtarët e familjes së punonjësit, etj.).

KATEGORI TË VEÇANTA TË TË DHËNAVE PERSONALE NE PËRPUNOJMË

- pamja fizike e punonjësve dhe personave të caktuar që lëvizin nëpër ambientet në BZhMV përmes video mbikëqyrje.
- kombësia
- feja
- të dhëna për gjendjen shëndetësore (raport për ndërprerje të përkohshme të punës) etj.

Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale kryhet në përputhje me nenin 13 paragrafi (2) dhe (3) dhe nenin 10 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

TRANSFERIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

BZhMV mund të transferojë të dhënat Tuaja personale në përputhje me rregulloret ligjore.

PERSONA TË AUTORIZUAR PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

BZhMV u lëshon punonjësve autorizime-vendime të veçanta për përpunimin e të dhënave personale të punonjësve dhe personave të caktuar në bankë. Këta persona të autorizuar, para se të fillojnë punën e tyre, por edhe nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme, familjarizohen me mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale.

Përpunuesit e të dhënave personale

BZhMV angazhon palë të ndryshme kontraktuese që veprojnë si përpunues të të dhënave personale. Ata kryejnë një pjesë të shërbimeve në emër dhe në llogari të bankës. BZhMV lidh marrëveshje për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale me përpunues të tillë kontraktualë në përputhje me klauzola standarde kontraktuale. Përpunuesit i përpunojnë të dhënat vetëm për realizimin e shërbimeve të përcaktuara me marrëveshje për BZhMV dhe për asnjë qëllim tjetër, dhe as nuk mund t'i përdorin ato për qëllimet e tyre ose për qëllimet e palëve të treta.

MASAT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Funksionimi dhe veprimet e BZhMV në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve dhe personave të caktuar në bankë janë plotësisht në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale në RMV. Ai nënkupton një sistem plotësisht të futur masash teknike dhe organizative për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale, si p.sh.

- zbatohen procedura strikte sigurie për të reduktuar rrezikun e shkeljes së sigurisë së të dhënave personale si zbulimi i paautorizuar, qasje e paautorizuar në të dhënat personale të personave fizikë dhe incidente të tjera të sigurisë;
- pajisjet/lokalet ku ruhen të dhënat personale janë të vendosura në një mjedis të sigurt me qasje të kufizuar fizike;

- përdoren mure mbrojtës (firewall) fjalëkalime të forta, programe antivirus dhe masa të tjera për mbrojtjen e të dhënave personale (p.sh. enkriptimi dhe pseudonimizim).
- vetëm personat e autorizuar kanë qasje në të dhënat personale brenda BZhMV, dhe autorizimet janë të rregulluara në përputhje me proceset e punës në bankë;
- punonjësit e BZhMV janë të përkushtuar për të garantuar besueshmëri;
- BZhMV zhvillon trajnime të rregullta për mbrojtjen e të dhënave personale për punonjësit, gjë që siguron një nivel të kënaqshëm të vetëdijes brenda organizatës.

PERIUDHA E RUAJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat ruhen në varësi të llojit të kategorive të subjekteve dhe qëllimit për të cilin përpunohen dhe në përputhje me Listën e materialit dokumentar me kushtet e ruajtjes së tij, domethënë:

Në dosjet e punonjësve: aplikimi dhe çregjistrimi i punonjësve, marrëveshje/vendimi për punësim, marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve me person drejtues, aneks i marrëveshjes, vendimet për themelimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës, vendimet për caktimin e punës ruhen për 45 vjet.

Dokumentet në lidhje me llogaritjen e pagës mbahen për 45 vjet.

Të dhëna për stazhin e punës, vërtetim të lartësis së pagave, ndalim administrativ, pushimi vjetor, mungesa, pushim mjekësor, të dhëna për deklaratat vjetore tatimore, deklarata etj. ruhen 2 vjet.

Materialet në lidhje me shpalljen dhe zbatimin e konkursit/shpalljes (vendimet për shpalljen, procesverbalet e komisionit, njoftimi, kundërshtimet etj.) ruhen për 1 vit.

Libra për regjistrime, plane, programe dhe materiale për arsimin dhe aftësimin profesional të punëtorëve, specializimin, bursat etj. mbahen për 10 vjet.

Materialet dhe aktet që lidhen me përgjegjësinë e punëtorëve (kërkesat për fillimin e procedurës, vendimet për ngritjen e komisionit, ftesat, procesverbalet e seancave, deklaratat, raportet e vlerësimit, vendimet për vendosjen e masave dhe kundërshtimet) ruhen për 3 vjet.

Letërkëmbimi në lidhje me ushtrimin e të drejtave nga një marrëdhënie pune mbahet për 1 vit.

TË DREJTAT E SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE PERSONALE

- E drejta për informacion dhe qasjen në të dhënat personale,
- E drejta për korrigjimin e të dhënave personale,
- E drejta e fshirjes së të dhënave personale,
- E drejta për të kufizuar përpunimin e të dhënave personale,
- E drejta për transferim të të dhënave,
- E drejta për të kundërshtuar dhe marrjen e automatizuar të vendimeve individuale,
- E drejta për të tërhequr pajtimin

Subjekti i të dhënave personale, me kërkesën e tij, mund të marrë informacione për:

- nëse përpunohen të dhënat personale për subjektin që paraqet kërkesën;
- cilat kategori të të dhënave personale përpunohen;
- për çfarë qëllimesh dhe cila është baza ligjore;
- përdoruesit ose kategoritë e përdoruesve;
- burimet e të dhënave personale;
- kushtet e ruajtjes së të dhënave personale;
- nëse të dhënat personale u transferohen vendeve të treta apo organizatave ndërkombëtare.

Për të realizuar të drejtat Tuaja, ju mund të paraqisni një kërkesë personalisht ose përmes një përfaqësuesi. Formulari gjendet në linkun e mëposhtëm:

- Kërkesë për të realizuar të drejtat e subjektit për të dhënat personale
- Autorizim

INFORMACIONE TË TJERA

Nëse keni ndonjë pyetje, vërejtje ose koment në lidhje me këtë Njoftim të Privatësisë, mund t'i drejtoni ato tek Oficeri i mbrojtjes së të dhënave personale të BZhMV.